

VENDIM
Nr.178, datë 25.5.1990

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHËRESËN E KËSHILLIT TË MINISTAVE NR.1, DATË
2.4.1975 “PËR KRIJIMIN DHE PËRDORIMIN E FONDIT TË AMORTIZIMIT NË
NDËRMARRJE”**

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministave

VENDOSI:

Në urdhëresën e Këshillit të Ministave nr.1, datë 2.4.1975, neni 6 ndryshohet si vijon:

“Fondi i amortizimit i krijuar rëndon, sipas rastit, koston e prodhimit, të ndërtimit, të shërbimeve e shpenzimet e qarkullimit të ndërmarrjes dhe përdoret për:

- a) Financimin e investimeve të vetë ndërmarrjes.
- b) Financimin e meremetimeve të mëdha të mjeteve kryesore të vetë ndërmarrjes.
- c) Për shlyerjen e kredisë afatgjatë për investime.
- ç) Derdhjen në buxhet të fondit të amortizimit për investime, sipas kritereve që përcakton Ministria e Financave.

Mjetet financiare të krijuara nga fondi i amortizimit për investime dhe për meremetime të mëdha, që rezultojnë si teprice në fund të vitit, mbarten nga ndërmarrja për t’u përdorur në vitin pasardhës.

Organet e financës dhe të bankës në rrethe ndjekin derdhjen e mjeteve financiare të fondit të amortizimit nga ana e ndërmarrjeve, sipas afateve të caktura”.

Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.1991.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
ADIL ÇARÇANI